REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org.
Org.Jedinica 02
Org Unit

Nr.Prot:
Broj Prot
Prot.No: 05-5011

Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -6-

Data:
Datum:
Date: 15/07/2026

Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: MARRJA, TRANSPORTIMI DHE MANIPULIMI I MOSTRAVE PËR DIAGNOSTIKIMIN E TUBERKULOZIT

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË MARRJES SË MOSTRAVE, TRANSPORTIT DHE PËRPUNIMIT TË MOSTRAVE, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR PËR IDENTIFIKIMIN E TUBERKULOZIT

VERSIONI:1.0
DATA E APROVIMIT:15.07.2026.
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NENHAPAVE: 37

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO-JE ËSHTË TË PËRCAKTOJË NË MËNYRË TË QARTË PROCEDURAT QË DUHET NDJEKUR PËR MARRJEN, ETIKETIMIN, RUAJTJEN, TRANSPORTIMIN DHE MANIPULIMIN E KORREKT TË MOSTRAVE KLINIKE PËR DIAGNOSTIKIMIN LABORATORIK TË TUBERKULOZIT (TB), DUKE SIGURUAR RUAJTJEN E CILËSISË SË MOSTRËS, SIGURINË E PACIENTIT DHE TË PERSONELIT LABORATORIK, SI DHE BESUESHMËRINË E REZULTATEVE LABORATORIKE. KJO PSO KA PËR QËLLIM STANDARDIZIMIN E PROCEDURAVE PËR MENAXHIMIN E MOSTRAVE NË PËRPUTHJE ME REKOMANDIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, DUKE SIGURUAR CILËSI, GJURMUESHMËRI DHE SIGURI GJATË GJITHË PROCESIT PREANALITIK. KJO PSO ZBATOHET PËR TË GJITHA MOSTRAT KLINIKE TË MBLEDHURA PËR DIAGNOSTIKIMIN E TB DHE REZISTENCËS NDAJ BARNAVE, TË CILAT ANALIZOHEN ME BACILOSKOPI, TESTE MOLEKULARE, KULTURË PËR MYCOBACTERIUM TUBERCULOSIS, TESTE TË IDENTIFIKIMIT TË MIKOBAKTEREVE, TESTE TË NDJESHMËRISË NDAJ BARNAVE DHE METODA TË TJERA LABORATORIKE PËR DIAGNOSTIKIMIN E TB. KJO PROCEDURË ËSHTË E DETYRUESHME PËR TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE QË MARRIN MOSTRA PËR DIAGNOSTIKIMIN E TB, PERSONELIN LABORATORIK DHE PERSONELIN PËRGJEGJËS PËR TRANSPORTIN E MOSTRAVE, SI DHE PËR LABORATORËT RAJONALË DHE REFERENTË TË TUBERKULOZIT QË MARRIN, TRANSPORTOJNË OSE PËRPUNOJNË MOSTRA PËR DIAGNOSTIKIMIN E SAJ. RESPEKTIMI STRIKT I KËSAJ PROCEDURE DHE MANIPULIMI NË PËRPUTHJE ME MASAT E BIOSIGURISË, ËSHTË THELBËSOR PËR SIGURIMIN E REZULTATEVE TË SAKTA DHE TË BESUESHME LABORATORIKE.
NDËRLIDHJA ME AKTET	DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË, 2025; LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE; PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; PSO PËR ASGJËSIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE –MSH, GUSHT 2023; PSO DEKONTAMINIMI NË RASTE TË DERDHJES SË MATERIALIT TË RREZIKSHËM DHE RREZIQEVE TJERA TË LABORATORIT; PSO- ZBATIMI I MASAVE TË BIOSIGURISË PËR MBROJTJE PERSONALE (BIO-P01-V1.0) PSO- PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E INKUBATORIT NË LABORATOR (BIO-P02-V1-0)
LISTA E SHKURTESAVE	PPM – PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE PSO – PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE TUBERKULOZI – TB BAL-LAVAZHI BRONKO-ALVEOLAR PPM- PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mjeku kërkon ekzaminimin laboratorik dhe informon pacientin për qëllimin e ekzaminimit, llojin e mostrës që duhet të jepet dhe mënyrën e mbledhjes së saj; 2. Infermieri ose laboranti udhëzon pacientin për marrjen e mostrës, siguron që mostra të merret në mënyrë korrekte, etiketon mostrën dhe plotëson dokumentacionin përkatës; 3. Mostra transportohet në laborator në përputhje me procedurat e përcaktuara për ruajtjen dhe transportin e mostrave klinike; 4. Personeli laboratorik kryen pranimin dhe verifikimin e mostrës, përfshirë kontrollin e identitetit, etiketimit dhe dokumentacionit shoqërues, sipas kritereve të pranimit dhe refuzimit të mostrave të përcaktuara në Doracakun e Cilësisë; 5. Personeli laboratorik kryen ruajtjen, manipulimin dhe përpunimin e mostrës në përputhje me procedurat laboratorike, si dhe regjistron dhe dokumenton të gjitha veprimet e kryera për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të mostrës.
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim	1. Sigurohu që të gjitha pajisjet dhe reagjentët e mëposhtëm janë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit; 1.1. Pajisjet përfshijnë: a. Kabinet i biosigurisë klasa II; b. Pajisje personale mbrojtëse; c. Frigorifer (2–8°C); d. Kontejner për mbetje biologjike; 1.2. Reagjentët e nevojshëm: e. Material për paketim të trefishte; f. Formularë standard laboratorikë; g. Enë sterile për marrjen e mostrave; h. Kontejnerë për këlbazë me kapak hermetik; i. Tuba sterilë për mostra të tjera klinike; j. Etiketa identifikimi; k. Qese ose kontejnerë për transport biologjik; l. Material absorbues; m. Dezinfektues të aprovuar.
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes së mostrës	1. Verifiko identitetin e pacientit sipas procedurave institucionale. 2. Shpjego qëllimin e ekzaminimit laboratorik dhe procedurën e marrjes së mostrës; 3. Udhëzo pacientin për mënyrën e saktë të mbledhjes së mostrës sipas llojit të saj; 4. Plotëso formularin e kërkesës laboratorike; 5. Përgatit materialet për marrjen e mostrës; 6. Vish pajisjet mbrojtëse personale (PPE) sipas PSO përkatëse;

		7. Përgatit enën sterile dhe të përshtatshme për llojin e mostrës dhe siguro që ajo të jetë sterile, rezistente ndaj rrjedhjeve, me kapak hermetik dhe sipërfaqe për etiketim; 8. Për mostrat e këlbazës, udhëzo pacientin të shpëlajë gojën vetëm me ujë, të marrë disa frymëmarrje të thella dhe të kollitet për të nxjerrë sekrecione bronkiale. Siguro që mostra të jetë mukoze ose mukopurulente, jo pështymë, me vëllim të mjaftueshëm (3–5 mL kur është e mundur); 9. Mblidh mostrat 4espiratorë ose jorespiratore sipas lokalizimit të infeksionit dhe metodës diagnostike (p.sh. BAL, aspirat gastrik, urinë, lëngje sterile trupore, biopsi ose mostra indore); 10. Mbylle menjëherë enën pas marrjes së mostrës për të shmangur kontaminimin dhe rrjedhjet; 11. Për mostrat ekstrapulmonare (lëngje sterile), mblidh lëngun cerebrospinal, pleural, perikardial, sinovial, ascitik ose qelbin në enë sterile dhe mos përdor konservues ose fiksues; 12. Shto tretësirë fiziologjike sterile nëse ekziston rreziku i tharjes së mostrës së indit; 13. Për mostrat e indeve, vendosi indet në enë sterile dhe mos përdor formalinë ose fiksues të tjerë; 14. Për mostrat e urinës, siguro mbledhjen e urinës së vrushkullit të mesëm dhe, kur kërkohet, mblidh tri mostra të mëngjesit në ditë të ndryshme; 15. Ruaji mostrat në frigorifer menjëherë pas marrjes, sipas kërkesave përkatëse; 16. Etiketo dhe dokumento mostrën me emrin dhe mbiemrin e pacientit, numrin identifikues, llojin e mostrës, datën dhe orën e marrjes; 17. Verifiko përputhshmërinë e të dhënave ndërmjet mostrës dhe formularit të kërkesës laboratorike.
[IV]	Veprimet laboratorike për transportin e mostrës	1. Paketimi i mostrës: 1.1.Vendose mostrën në enën primare sterile me kapak hermetik; 1.2.Mbështille enën me material absorbues; 1.3. Vendose në paketimin sekondar rezistent ndaj rrjedhjeve; 1.4. Vendose paketimin sekondar në paketimin e jashtëm transportues; 1.5.Vendos dokumentacionin shoqërues në xhep të veçantë, jashtë paketimit të mostrës. 2. Transporti i mostrës: 2.1. Transporto mostrën sa më shpejt të jetë e mundur pas mbledhjes; 2.2.Transporto mostrat e këlbazës brenda 24–72 orëve sipas kërkesave laboratorike;

		2.3. Ruaj mostrat në temperaturë 2–8°C në rast vonesash; 2.4. Transporto mostrat ekstrapulmonare menjëherë pas marrjes; 2.5. Shmang ekspozimin ndaj nxehtësisë dhe rrezeve të drejtpërdrejta të diellit gjatë transportit. 3. Pranimi i mostrës në laborator: 3.1. Regjistro mostrën në regjistrin e mostrave në laborator dhe në sistemin informatik (p.sh. MedLis); 3.2. Kontrollo integritetin e paketimit, përfshirë: a. Përputhshmërinë e mostrës me formularin e kërkesës; Etiketimin korrekt; b. Integritetin e enës; c. Sasinë e mjaftueshme të mostrës; d. Kushtet e transportit. 3.3. Verifiko përputhshmërinë e dokumentacionit shoqërues; 3.4. Dokumento çdo moskonformitet sipas procedurave të laboratorit.
[V]	Veprimet laboratorike për manipulimin me mostra	1. Trajto të gjitha mostrat si potencialisht infektive gjatë gjithë procesit të manipulimit dhe përpunimit; 2. Kryej manipulimin e mostrave në përputhje me kërkesat e biosigurisë dhe procedurat institucionale të miratuara; 3. Apliko procedurat e biosigurisë në punë duke iu referuar gjithmonë PSO-së për dekontaminim në rast derdhjesh të materialit të rrezikshëm dhe PSO-së për zbatimin e masave të biosigurisë për mbrojtje personale (BIO-P01-V1.0), me qëllim parandalimin e ekspozimit të personelit dhe përhapjes së aerosoleve që mund të përmbajnë *Mycobacterium tuberculosis*; 4. Udhëzo pacientin që mostra e këlbazës të merret në ambient të hapur ose në hapësirë të dedikuar dhe të ajrosur mirë; 5. Mos lejo marrjen e mostrës në ambiente të mbyllura si laboratori, tualeti ose dhomat e pritjes; 6. Informo pacientin për mënyrën korrekte të nxjerrjes së këlbazës për të siguruar cilësinë e mostrës dhe për të shmangur kontaminimin; 7. Vish pajisjet mbrojtëse personale (PPM), sipas vlerësimit të rrezikut dhe në përputhje me PSO mbi masat e Biosigurisë për Mbrojtje Personale (Bio-P01-V1.0); 8. Dezinfekto sipërfaqet e punës para dhe pas manipulimit të mostrave; 9. Kryej të gjitha procedurat që gjenerojnë aerosole vetëm në Kabinetin e Biosigurisë Klasa II; 10. Ruaj dhe menaxho mostrat sipas kërkesave të temperaturës së përcaktuar:

		a. +4°C: urina, këlbaza, lëngu perikardial, aspirati bronkial, indet, lëngu ascitik, bioptatet; b. 22–25°C: lëngu sinovial, palca kockore; c. 37°C: lëngu cerebrospinal.
[VI]	Veprimet laboratorike për menaxhimin e dokumentacionit	1. Siguroji disponueshmërinë e dokumentacionit dhe Regjistrat e nevojshëm: a. Formulari i kërkesës laboratorike; b. Regjistri i pranimit të mostrave; c. Regjistri i refuzimit të mostrave; d. Regjistri i transportit të mostrave; e. Regjistrat laboratorikë përkatës.

Referencat:

- WHO. Laboratory Services in Tuberculosis Control.
- WHO Consolidated Guidelines on Tuberculosis.
- GLI (Global Laboratory Initiative) – TB Specimen Collection, Transport and Processing.
- CLSI Guidelines for Microbiological Specimen Management.
- MOSTRIMI NË MIKROBIOLOGJINË KLINIKE- Gjyle Mulliqi – Osmani, Lul F. Raka Prishtinë, 2013